



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 04 257 – 924

Nr. 275/11 Prot

Tiranë më 30/05/2016

V E N D I M

Nr. 57, Datë 30.05.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK
TË USHTRUAR NË SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEC

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e kontrollit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, në mbështetje të neneve 15 dhe 25 të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

V E N D O S A

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Pogradec, në bazë të programit të auditimit nr. 275/1, datë 29.02.2016, me objekt: "Mbi shqyrtimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në procedurat e prokurimit "Blerje automjeti për nevojat e Shoqërisë" dhe "Blerje automjeti për nevojat e punimeve të Shoqërisë, si dhe zbatimin e kontratave në lidhje me to", për periudhën kohore të veprimtarisë së këtij subjekti nga data 01.01.2015 deri më datë 01.03.2016.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Bazuar në shkeljet e konstatuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit "Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë" në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar:

Rekomandojmë:

Nga ana e Auditit të Brendshëm të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime, Pogradec, të kryhet auditimi i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë për të gjithë periudhën e drejtimit të saj nga ish-Drejtori i Përgjithshëm V.G, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë të gjitha procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë kësaj periudhe.

(Një kopje e Raportit Përfundimtar të këtij auditimi ti dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit.)

Menjëherë

B. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në shkeljet e konstatuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit “Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë” në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

Rekomandojmë:

Agjencia e Prokurimit Publik, në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 13 dhe 72, të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Kreun XI, neni 79 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, të shqyrtojë dhe merrë në analizë të gjitha faktet dhe gjetjet e këtij Raporti Auditimi në lidhje me zhvillimin e procedurave fiktive të prokurimit “Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë”, duke konkluduar më pas në përgjegjësinë përkatëse disiplinore të të gjithë personave, nëpunës dhe ish-nëpunës të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, të cilët do rezultojnë me shkelje.

(Një kopje e Vendimit të APP në lidhje me shkeljet e konstatuara dhe masat përkatëse administrative ti dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit.)

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në shkeljet e konstatuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit “Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë” në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe Ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Rekomandojmë:

Sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, në shqyrtim të shkeljeve të konstatuara dhe evidentuara në këtë Raport Auditimi, të iniciojë procedurat përkatëse disiplinore ndaj të gjithë punonjësve përkatës të kësaj shoqërie, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë”, duke konkluduar më pas në dhënien e masave përkatëse disiplinore, sipas përgjegjësisë individuale të gjithsecilit, nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”.

Menjëherë

Sqarim:

Në lidhje me përgjegjësinë administrative/disiplinore të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, V.G, sqarojmë që në rast se ai do vazhonte të qëndronte ende në detyrë, ndaj tij do të rekomandonim masën e “largimit të menjëhershëm nga detyra”.

D. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në shkeljet e konstatuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, lidhur me zhvillimin fiktiv të procedurës së prokurimit “Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë” me qëllimin e shitjes ndaj sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, të ish-makinës personale të ish-Drejtorit të kësaj shoqërie, me një çmim të rritur artificialisht, minimalisht në vlerën 3,756,950 Lekë.

Rekomandojmë:

Nga ana e sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, të iniciohen dhe ndiqen të gjitha procedurat përkatëse administrative për nxjerrjen e urdhrin për shpërblimin e dëmit nga ana e **V.G** në vlerën prej 3,756,950 lekë, duke ndjekur më pas në rastin e moszbatimit vullnetar të këtij detyrimi nga ana e **V.G**, të gjitha procedurat përkatëse të çuarjes dhe kërkimit të shpërblimit të këtij dëmi në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

E. KALLËZIM PENAL

Në kushtet kur shkeljet e konstatuara nga ky auditim dhe që përmbanin elementë të figurës së veprës penale të “shpërdorimit të detyrës dhe “shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” kanë qenë tepër evidente që në fazën e auditimit në terren dhe më pas në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, KLSH në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 10.5.7 pika 5, të “Rregullores së Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit” ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec, kallëzimin penal nr. 275/8 prot, datë 20.04.2016 ndaj ish-Drejtorit të sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, **V.G**.

Sa më sipër, në kushtet e kryerjes së kallëzimit penal përpara përfundimit të procedurave normale të auditimit, ky Raport Përfundimtar Auditimi do ti përcillet për veprime të mëtejshme procedurale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të rekomandimeve të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike.

K R Y E T A R

Bujar LESKAJ